

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil, si gjykatë e shkallës së parë civile gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkëpunëtorin profesionale Hakile Ilazi, në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] të cilin e përfaqëson Av. A [REDAKTUAR] me autorizim, kundër të paditurve Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit në Ferizaj, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i Komunës Adem Aliu me autorizim, baza e kontestit: pagesa e pagave jubilarë si dhe paga për përcjellje në pension, vlera e kontestit 1.935,85 €, pas përfundimit të seancës kryesore publike të mbajtur me dt. 07.05.2013 në prezencën e paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesë padia e paditësit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], kundër të paditurës Komuna Ferizaj - Drejtoria për Arsimit si e bazuar.

OBLIGOHET e paditura që paditësit ti paguaj shumën prej 1.548,28 € (njëmijë e pesëqind e dyzet e tetë euro e njëzet e tetë cent) dhe atë shumën prej 774.14€ në emër të pagesave të dy pagave jubilarë, dhe shumën 774.14 € në emër të pagesës të dy pagave për përcjellje në pension, me kamatë prej 3.5% nga data 04.02.2013 deri në përmbushjen definitive si për mjetet e deponuara në bankë për një vit pa destimim të caktuar, si dhe shpenzimet kontestimore në shumë prej 98 € të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

REFUZOHET kërkesa e paditësit në shumë prej 387.07€ në emër të një page jubilarë si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Paditësi në padi dhe në seancën e mbajtur në këtë gjykatë ka deklaruar që mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe shton se pas pensionimit të tij, mësimdhënës, e paditura ndaj tij nuk ka përmbushur detyrimet financiare për pagesën pagave jubilarë si dhe pagave për përcjellje në pension, me kamatë përkatëse si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Si mbështetje të kërkesë padisë ka bashkangjitur provat përkatëse mbi bazën e të cilave konsideron se kërkesë padia është e bazuar dhe si e tillë i propozon gjykatës që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar.

Përfaqësuesi i të paditurës ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesë padinë dhe kërkesë padinë paditësit si të pa bazuar, bazën juridike për realizimin e pagesave të theksuara në padi, paditësi i ka mbështet në nenin 42, 43 dhe 44 të KPK i cili ka hy në fuqi me 01.01.2005 paditësi është pensionuar me datë 22.10.2010, kontrata kolektive nuk ka qenë në fuqi. Në rregulloren nr. 2001/27 për LTHP, neni 6. 4, shprehimisht thuhet se kontrata kolektive nuk zgjat më shumë se tri vite.

Kontrata kolektive ka hyr në fuqi me 01.01.2005 e njëjta nuk është vazhduar edhe pas kalimit të afatit prej 3 vitesh. E konteston edhe nga baza se paditësi e ka fituar të drejtën e pensionit në kohën kur ka qenë në fuqi rregullorja mbi pensionet në Kosovë, nr. 2001/35 me të cilën me asnjë nen nuk parashihet pagesa e pagave përcjellëse për shkuarje në pension.

Nga theksimet e lartë cekura rezulton nuk ekziston asnjë bazë juridike që paditësi t'i pranohet e drejta në kompensimin e tri pagave mujore jubilarë dhe dy pagave për përcjellje në pension dhe të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

(Ligji nr.03/L-147 G.Z.RKS Prishtinë viti V nr.72/25.06.2010) me të cilën përcaktohet se nëpunësit civil kanë të drejtë për pagesa tjera në rrethane të veçanta, ku neni 22 paragrafi 2.3 i këtij ligji përcakton të drejtën në shpërblim i përvjetorit (jubile) dhe neni 22 paragrafi 2.5 përcakton pagesën në rast të pensionimit, ndërsa Qeveria në bazë të nenit 27 par.2 të këtij Ligji ka pasur për obligim nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij Ligji në afatin prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi i këtij Ligji.

Andaj duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura Gjykata konsideron se deri sa nuk rregullohet në mënyrë tjetër ashtu siç është rregulluar me kontratën e përgjithshme kolektive të Kosovës dhe me kontratën kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë respektivisht nenet 50 dhe 51, të kësaj kontrate, kanë zbatim deri sa me akte nënligjore nuk përcaktohen në mënyrë të saktë pagesat nga neni 22 paragrafi 2 pika 3 dhe 5 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil, pasi është obligim i Ministrisë dhe Qeverisë që të nxjerr aktet nënligjore me të cilat do të zbatoheshin dispozitat me të cilat të punësuarve ju njohur të drejtat, në rastin konkret në pagë jubilarë dhe me rastin e pensionimit.

Në nenin 50 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se në rastin konkret i punësuarit, paditësi, këtë të drejtë e ka pasur në shpërblim të dy pagave jubilarë që në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate jubilarë, pasi e ka pasur përvojën e punës mbi 30 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim nga ana e të punësuarit.

Në nenin 51 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, të dt. 27.10.2005, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesën përcjellëse në lartësi të dy pagave minimale mujore të punëtorit në Kosovë për tre muajt e fundit, gjegjësisht dy paga mesatare të punëtorit për tre muajt e paguar nëse për punëtorin kjo është më e përshtatshme, çka do të thotë se në rastin konkret duke marr për bazë pagën e të punësuarit në shumë prej 387.07€ do të ishte më e përshtatshme për punëtoren që të merret paga e saj bazë.

Pretendimet e të autorizuarit të paditurës se kontrata kolektive ka qenë në fuqi prej dt. 01.01.2005 deri më 31.12.2007, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 6 të Rregullores nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në bazë të të cilit thuhet "marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar në kohëzgjatje për jo më shumë se tre vjet", Gjykata këtë pretendim e konsideron si jo të arsyeshëm dhe jo me bazë ligjore për faktin se Rregullorja 2001/27 nuk gjen aplikim te të punësuarit në arsim, ndërsa Kontrata e përgjithshme kolektive nuk ka përcaktuar ndonjë afat për të cilin do të pushoj së vepruari, por edhe nën supozimin se kjo kontratë do të kishte vlefshmërinë e saj për tri vite këtë të drejtë paditësi e realizon bazuar në nenin 34 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë lidhur me nenin 22 paragrafi 2 pika 3 dhe 5 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil.

Gjykata nuk gjeti bazë për aprovimin e një page jubilarë – pagave përcjellëse në pension të paditësit dhe kërkesën e tillë ia ka refuzuar si të pabazuar, ngase në bazë të nenit 50 dhe 51 të kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë thuhet: Punëtori ka të drejtë, me rastin e pensionimit në pagesën përcjellëse në

Shpenzimet procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi, si dhe përmes të autorizuarit ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar, për nga baza juridike, paditësi me dt. 22.10.2013 është pensionuar kur kontrata kolektive nuk ishte në fuqi. Në rregulloren për Ligjin Themelor të Punës numër 2001/27 neni 6 paragrafi 6.4 dhe me ligjin e punës 01.11.2010 neni 90 shprehimisht thuhet "Kontrata Kolektive nuk zgjat më shumë se tri vite"

Nuk është deklaruar për shpenzimet e procedurës.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë ushtrimin e provave me leximin e librezës së punës së paditësit nr. 1590/7, vendimi mbi njohjen e së drejtës në pension për paditësin me dt. 21.11.2012, vërtetimi i Shf " [REDACTED] " lëshuar për paditësin nr. 88 dt. 20.12.2012, vendimi i Trustitit të kursimeve pensionale të Republikës së Kosovës të dt. 25.10.2012, shkresat e dt. 17.01.2013 nr. 33/04, për refuzimin e kërkesës së paditësit nga e paditura, për pagesën e shpërblimit dhe përcjellje në pension.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj edhe e aprovon.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimin në padi nga ana e paditësit se te e paditura ka punuar për një periudhë mbi 45 vjeçare.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë të dy pagave jubilarë, në shumën prej 774.14€, si dhe të dy pagave për përcjellje në pension në shumën prej 774.14 € ka marr për bazë pagën mesatare të palës që e ka marr në tre muajt e fundit që ka qenë në shumën prej 387.07 €, sa ka qenë i punësuar tek e paditura pasi që kjo për paditësin është më e përshtatshme.

Gjykata me rastin e aprovimit pjesërisht të kërkesë padisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe punëdhënësin Oda Ekonomike e Kosovës, e cila është nënshkruar nga të tri palët dhe në nenin 64 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01. janar 2005, kjo kontratë me as një nen të saj nuk është përcaktuar se cila është koha e validitetit në mes palëve. Në pjesën hyrëse të kontratës kolektive thuhet se kontrata kolektive është nxjerr në mbështetje të nenit 6 të Rregullores nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovës, Rregullores nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, çka do të thotë se si bazë për shërbyesit civil është marr Rregullorja 2001/36, pasi Rregullorja 2001/27 nuk mund të aplikohet për shërbyesit civil pasi këtë cilësi e kanë mësimdhënësit sa i përket pagave dhe kushteve të punësimit, në bazë të nenit 34 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë (Ligji nr.2002/2) përcakton se postet që mbulohen nga ky Ligj, pagat dhe kushtet e punësimit, caktohen në përputhje me ligjin përkatës për administratën shtetërore, e që në bazë të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 3 dhe 5 lidhur me nenin 27 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil


lartësi të dy pagave minimale mujore të punëtorit në Kosovë për tre muajt e kaluar, gjegjësisht dy paga mesatare të punëtorit për tre muajt e kaluar, nëse për punëtorin kjo është më e përshtatshme, e të cilat paga janë aprovuar si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452.1 të LPK_së, ashtu që obligohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 98 €, dhe atë për padi 78 €, dhe aktgjykim në shumë prej 20€

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.91/13 më dt. 07.05.2013

Gjyqtari,
Enes Mehmeti



KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUNDËSHËM
ODLIKA JE PRAVNOBNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAČ

—CA 1866/13



Republika e Kosovës Republika Kosovo

SAKTËSHINË E POPËRË E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE

